REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

# VENDIM

**Nr.** 240 **, datë** 14.4.2021

**PËR**

**KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SHIJAK TË OBJEKTIT ARSIMOR, SHKOLLA E MESME E BASHKUAR "KAJO KARAFILI", BASHKIA SHIJAK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Shijak të objektit arsimor shkolla e mesme e bashkuar "Kajo Karafili", Bashkia Shijak, sipas listës së inventarit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRAÇE**

MINISTRI I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN

ARBEN AHMETAJ

Te dhenat e permbledhura per Objektet Arsimore (Tabela nr.1)

| Nr. | Qarku | Bashkia | Njesia Administrative | Niveli | Emertimi | Tipologjia e Nderhyrjes | Financimi i Ndertimit | Siperfaqe ($m^2$) | Vlera e Projekt Idese | Vle e projektit te zbatimit dhe ndertimit | Vlera e Mbikeqeresit | Vlera e koaludimit | Vlera totale e objektit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 17 | Bashkia Shijak | Shijak | Maminas | e mesme | Kajo Karafili | Ndertim | Buxhet GoA | 2,895.0 | 644,700.00 | 123,500,562.00 | 1,313,298.00 | 118,389.22 | 125,576,949.22 |
| | | | *TOTAL* | | | | | *2,895.0* | *644,700.0* | *123,500,562.0* | *1,313,298.0* | *118,389.2* | *125,576,949.2* |